

V E N D I M
Nr.427, datë 9.9.1999

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.230, DATË 22.5.1999 “PËR STRUKTURËN DHE ORGANIKËN ANALITIKE TË
ADMINISTRATËS DOGANORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, të ligjit nr.8849, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Financave

KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.230, datë 22.5.1999 të bëhen ndryshimet dhe shtesat si vijon:

1.Në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në vijin të organikës së doganës në Sarandë shtohet pika doganore e Qafës së Botës, me 11 punonjës, me këtë përmbërje:

- shef	1
- shef turni	2
- doganierë	8

Numri i përgjithshëm i punonjësve nga 1007 bëhet 1018.

Po në lidhjen nr.2, në strukturën e Departamentit Operativ Hetimor, emërtimi “Njësi detare e antikontabandës” ndryshon dhe bëhet “Dega e antikontabandës detareë. Struktura e kësaj dege, pa ndryshuar numrin e përgjithshëm të punonjësve, ndryshon si vijon:

- kryetar dege	1
- komandant grupi	8
- doganierë	17
- teknikë	23
- shofer	1

2.Në pikjën 2, në paragrafin IV, në Kategorinë C2, shtohen funksionet “llogaritar në degën doganore të Tiranës, të Durrësit dhe të Shkodrës”.

3. Efektet financiare të këtij vendimi të përballohen nga fondi i miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko